



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 132/6 Prot.

Tiranë, më 28.07.2026

V E N D I M

Nr. 207, Datë 28.07.2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 17, datë 14.01.2026¹, e paraqitur nga z. E.Z kundër Bashkisë Tiranë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “bindjes politike”, “bindjes fetare”, “gjendjes shoqërore²” dhe “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, dhe me email-in datë 28.01.2026, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “ - Diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

Gjatë muajit Shkurt 2025, është ushtruar presion institucional për të marrë pjesë në një tubim politik para institucioneve SPAK-ut dhe GJKKO në mbështetje të Kryetarit të Bashkisë, pasqyruar këto me fakte të publikuara në media. Gjithashtu, njoftimet për pjesëmarrje në këto aktivitete janë kryer në ambientet e brendshme të punës përmes komunikimeve gojore. Refuzimi im për t’u bërë pjesë e këtij aktiviteti ka shërbyer si shkak për nisjen e një fushate hakmarrëse. Deklaroj me

¹ Ankesa është plotësuar me informacionin e dërguar nga ankuesi me email-in datë 29.01.2026.

² “Statusi im shoqëror dhe pozicioni në punë janë më të ulëta në krahasim me anëtarët e Komisionit të Disiplinës dhe punonjësit që iniciuan shpifjet ndaj meje”.

³ Pa përcaktuar një cilësi apo karakteristikë personale.

⁴ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

përgjegjësi të plotë se nuk jam anëtar i asnjë force politike, nuk rezultoi i regjistruar në asnjë subjekt politik dhe nuk marr pjesë në asnjë formacion, parti apo shoqatë me karakter politik.

- *Përndjekja pas vendimit gjyqësor në favorin tim ndaj Komisionit Disiplinor, Bashkia Tiranë.*

Pas fitimit të procesit gjyqësor me vendim të formës së prerë me datë 02.12.2025, institucioni ka intensifikuar veprimet ndëshkuese. Brenda vetëm 20 ditëve nga ky vendim, janë ngritur dy komisione disiplinore të njëpasnjëshme me qëllim goditjen dhe largimin tim nga puna.

- *Diskriminimi fetar dhe cenimi i dinjitetit.*

Jam përballur me shpifje të qëllimshme për konsum alkooli gjatë punës, me synim diskreditimin tim, duke qenë në dijeni të bindjeve të mia fetare, pasi këtë fakt ua bëra të qartë anëtarëve të komisionit të disiplinës me nr. 38025/1, datë 14.11.2025, në seancën dëgjimore. Pavarësisht kësaj, vetëm ndaj meje është kërkuar kryerja e testit të alkoolit, gjë që përbën një trajtim të diferencuar dhe diskriminues, pa asnjë provë apo indicie që ta justifikojë këtë kërkesë. Gjithashtu, po gjatë kësaj seance më është kërkuar në mënyrë arbitrare të mos përmend “zotin” në ambientet e mbajtjes së seancës së Komisionit të Disiplinës.

- *Shkelje e parimit të barazisë në punë. Trajtimi i pabarabartë në punë.*

Jam lëvizur nga pozicioni i punës 4 herë brenda rreth një muaji. Jam i vetmi punonjës (nga rreth 600 gjithsej) të cilit i kërkohet testim alkooli në mënyrë selektive gjatë procesit të seancës dëgjimore nga komisioni i disiplinës i cili bazohet në shpifjet e bëra nga institucioni i policisë bashkiake pa asnjë provë. Të gjitha këto janë të administruara në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i disiplinës në datë 03.12.2025, por që mua nuk më jepen si informacion edhe pse kam kërkuar një gjë të tillë duke u diskriminuar nga e drejta për informim. Gjatë proceseve disiplinore, më është mohuar njohja me provat dhe e drejta e regjistrimit, duke shkelur çdo standard të procesit të rregullt administrativ.

Lëvizja nga pozicioni i punës me datë 15.08.2025, gjatë periudhës së lejes së zakonshme nga data 05 deri më 19.08.2025, sipas Nenit 12 të Ligjit nr. 10221/2010, të ndryshuar, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë kritere të barabarta në transferimet e punonjësve. Fakti që jam lëvizur 4 herë, 15.08.2025 nga inspektor tek drejtoria e sigurisë objekteve tek drejtoria e kontrollit të territorit, 2 ditë inspektor i njësisë nr. 2, pas dy ditësh inspektor i njësisë lagja nr. 14, me datë 11.11.2025, kaloj inspektor i grupeve mbështetëse brenda një periudhe shumë të shkurtër (rreth 50 ditë), ndërkohë që kolegët e tjerë kanë qëndrueshmëri në detyrë, vërteton se këto lëvizje nuk janë bërë për nevojat e institucionit, por si mjet ndëshkimi dhe presioni psikologjik.

Mospasja e një ndihmës polici gjatë periudhës si inspektor njësie, nga data 01.09.2025 deri me datë 10.11.2025, ndërkohë që kolegët e tjerë kanë pasur një polic ndihmës.

- *Trajtim përçmues dhe shkelje procedurale institucionale:*

Trajtimi arbitrar duke hequr ditën e punës datë 19.10.2025 dhe duke nisur informacion për ecuri disiplinore, dy dënime njëkohësisht, pa pasur një urdhër pune të protokolluar, apo një VKM për këtë datë, edhe pse dita e diele është ditë pushimi zyrtar, duke shtuar kështu një element shtesë të cenimit të të drejtave të punës dhe trajtimit të pabarabartë.

Mohimi i të drejtës për t'u njohur me informacionin dhe provat e mbledhura kundër, mungesë e transparencës, duke cenuar parimin e barazisë së të drejtave procedurale.

Heqja e të drejtës së regjistrimit të seancës disiplinore në audio, pa asnjë bazë ligjore.

Ngritja e Komisionit Disiplinor në mënyrë të përsëritur datë 03.12.2025 madje edhe 1 (një) ditë pas një vendimi gjykate të formës së prerë, të nesërmen.

Ngritja e një komisioni të ri, datë 03.12.2025 dhe datë 22.12.2025, për dhënien e masës disiplinore menjëherë pas vendimit të gjykatës datë 02.12.2025.

Paragjykim i qartë duke e trajtuar ankuesin si “shkelës të disiplinës” qysh në mënyrën e njoftimit, pa u dëgjuar dhe pa dalë në konkluzion.

Këto veprime dhe mosveprime të Bashkisë Tiranë përbëjnë një model të qartë diskriminimi institucional, diskriminimi në punë dhe trajtimi të pabarabartë, me shkaqe të qarta që lidhen me bindjen fetare, mospërkatesinë të asnjë bindjeje partiake, duke cenuar dinjitetin dhe integritetin profesional të ankuesit.

Gjithashtu ju bëj me dije se jam punonjës i Policisë Bashkiake Tiranë në pozicionin “Inspektor i policisë bashkiake”, emëruar me Urdhrin nr. 12491, datë 29.03.2023, urdhrin nr. 24139, datë 20.06.2024, urdhrin nr. 1543, datë 15.09.2025 dhe urdhrin nr. 1987, datë 10.11.2025, ku përmes kësaj ankese, kërkoj gjithashtu ndërhyrjen tuaj për të konstatuar diskriminimin financiar që po më bëhet në llogaritjen e pagës mujore. Paga ime bruto është 81.800 lekë, vlerë e cila i korrespondon vetëm “Shtesës për pozicion” sipas Lidhjes nr. 3, pika 7, të VKB nr. 47, datë 03.05.2023. Megjithëse zotëroj arsimin Bachelor, Bashkia Tiranë refuzon të më llogarisë shtesën prej 10.000 lekësh të parashikuar në tabelën “Vlera e pagës së grupit” të po këtij vendimi.

Mohimi i vjetërsisë në punë. Nuk më llogaritet shtesa prej 2% pas çdo viti pune (vjetërsia), ndonëse punonjësit e tjerë e marrin vjetërsinë. Ky trajtim i pafavorshëm sjell pabarazi në raport me kolegët e tjerë që u njihet arsimi dhe vjetërsia”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁵, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁵ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 132/1, datë 10.02.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti, lidhur me pretendimet e ankueses.

Me shkresën nr. 6157/3, datë 26.02.2026, Bashkia Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “1. Pretendimi i diskriminimit për shkak të bindjeve politike.

Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin administrativ urdhër, njoftim apo komunikime zyrtare të institucionit nuk rezulton asnjë evidencë që të mbështesë pretendimin se nga institucioni është kërkuar pjesëmarrje e detyrueshme e punonjësve në aktivitete me natyrë politike, ndaj çdo paraqitje ka qenë individuale dhe jashtë funksionit zyrtar. Konkretisht, z. E.Z me datë 12.02.2025 ka qenë ditë pushimi, pra jo në varësinë e punëdhënësit të tij.

Ky fakt vërtetohet sipas Librit të Shërbimit me nr. Rendor 5 (pesë), protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. 782, datë 27.01.2025, si dhe sipas grafikut të shërbimit ditor të datës 12.02.2025 të Drejtorisë së Sigurisë së Objekteve në Policinë Bashkiake.

2. Pretendimi diskriminues dhe jo ligjor mbi ngritjen e një komisioni disiplinor pas një vendimi të formës së prerë të gjykatës administrative.

Fillimi i ecurisë disiplinore ka nisur nëpërmjet shkresës me nr. 38025, datë 04.11.2025 ardhur nga Policia Bashkiake (Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtimit dhe Koordinimit) me lëndë: “Dërgim informacioni në lidhje me konstatimet e shkeljeve disiplinore të efektivit z. E.Z. Bashkëlidhur shkresës është informacioni mbi shkeljet e kryera dhe fillimi i ecurisë disiplinore për punonjësin. Bazuar në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor nëpërmjet shkresës së dërguar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Bashkiake, arsyeja e fillimit të procedurës disiplinore është shkelja e germës “a”, “c”, “e”, “gj”, dhe “j” pika 1, të nenit 39, të Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, konstatuar nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Territorit, u ngrit Urdhri i Kryetarit për “Ngritjen e Komisionit Disiplinor” nr. 38025/1, datë 14.11.2025 dhe njoftimit me nr. 38025/2, datë 21.11.2025.

Nga shqyrtimi që Komisioni Disiplinor i bëri materialeve në dispozicion të hetimit, rezultoi se:

Gjatë relatimit eprori i tij pohoi se punonjësi z. E.Z, ka treguar në vazhdimësi një mungesë të theksuar të moszbatimit të urdhrave për kryerjen e detyrave si edhe për pjesëmarrjen në mbledhjet

e organizuara nga Drejtoresha e Përgjithshme e Policisë Bashkiake. Ndër rastet që mund të përmenden, si më poshtë vijon:

Me datë 29.10.2025, në orën 15:45, në mbledhjen e kryer me stafin e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit, z. E.Z nuk ishte i pranishëm. Njoftimi është kryer në rrjetin e mesazheve, në grupin e Drejtorisë, ku nga ana e punonjësit z. E.Z nuk është dhënë asnjë koment.

Me datë 15.10.2025, z. E.Z ka raportuar se ka marrë shërbimin pranë shkollës “Betim Muço”, dhe ndërkohë nga shefi i tij (prezent në seancën e datës 22.01.2026, në cilësinë e dëshmitarit, i cili pohon verdiktin e eprorit) nuk është konstatuar prezent në vendin e detyrës së ngarkuar.

Me datë 19.10.2025, gjatë aktivitetit “Maratona Tiranë 2025”, për shkak të të cilës janë njoftuar të gjithë se lejet anulohen dhe duhet të jenë të disponueshëm në shërbim, punonjësi z. E.Z nuk është paraqitur. Lidhur me këtë pohim, është sjellë për depozitim si provë, urdhri i brendshëm nr. 4375, datë 14.10.2025, “Për anulimin e lejes vjetore” si edhe plani i masave me nr. 4376, datë 14.10.2025, “Për zbatimin e masave në mbarëvajtjen e aktivitetit “Maratona Fun Run” dhe “Maratona e Tiranës 2025” që do të zhvillohet me datë 18-19.10.2025”.

Subjekte të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të përcjella me shkresë zyrtare pranë Policisë Bashkiake, ka rezultuar se punonjësi z. E.Z i ngarkuar për zbatimin dhe verifikimin e hapësirave publike nën mbulimin e tij, nuk ka marr masat e duhura.

Punonjësi i proceduar u shpreh në seancë se, sa i përket mbledhjes së kryer me stafin e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit, me datë 29.10.2025, në orën 15:45, ka qenë periudhë përtej orarit të tij zyrtar të punës për atë ditë.

Lidhur me aktivitetin “Maratona Tiranë 2025” me datë 19.10.2025, punonjësi citoi se kjo ditë ishte ditë e diel dhe është ditë pushimi zyrtar.

Sa i përket pretendimeve të tjera, thjesht deklaroi se sipas tij nuk qëndronin. Në mbështetje të deklaramëve të tij, z. E.Z ka sjellë dhe një relacion gjatë zhvillimit të shqyrtimit disiplinor. Komisioni Disiplinor, unanimisht vlerësoi se, sa më lart u parashtrua, dhe shqyrtimit të dokumentacionit gjatë procedimit, masa disiplinore e parashikuar në nenin 44, të pikës 1 shkronja “b/i” të Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, është proporcionale me shkeljet e kryera prej punonjësit. Kjo masë duhet të konsiderohet si një mundësi reflektimi me qëllim korrigjimin e sjelljes dhe rifitimin e besimit ndaj eprorëve.

Referuar vendimit datë 02.12.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të çështjes nr. 31154-03937-80-2024, ju informojmë se ky vendim nuk është administruar pranë Bashkisë Tiranë.

Në seancën e datës 03.12.2025 është paraqitur prej tij, dispozitivi i vendimit gjyqësor i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, me datë 02.12.2025 dhe nr. 31154-03937-80-2024.

Ju informojmë se vendimi gjyqësor përfundimtar ka fuqi juridike dhe është i detyrueshëm për ekzekutim nga palët, vetëm nëse përmban elementet e parashikuara në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe është dhënë nga gjykata me ekzekutim të përkohshëm sipas nenit

317 të Kodit të Procedurës Civile, apo ka marrë formë të prerë sipas neneve 451 dhe 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

3. Pretendimi i diskriminimit për shkak të besimit fetar, cenimi i dinjitetit gjatë seancave disiplinore, si edhe pretendimi i diskriminimit si rrjedhojë e kërkesës për kryerjen e një testi toksikologjik.

Bazuar në verifikimin e procesverbaleve të seancave disiplinore, nuk rezultoi të jetë kryer ndonjë kufizim apo ndalim ndaj punonjësit për të shprehur bindjet e tij fetare. Punonjësi ka pasur të drejtën për tu shprehur, përpara anëtarëve të komisionit duke synuar respektimin e komunikimit institucional dhe ruajtjen e fokusit në objektin e shqyrtimit dhe trajtimin e barabartë të palëve.

Kërkesa për të kryer testin toksikologjik, është bazuar mbi dyshimin e arsyeshëm, referuar në materialin fillestar të kërkesës së eprorit të tij me nr. 38025, datë 04.11.2025, për nisjen e ecurisë së procedurës disiplinore. Kërkesa është bërë në mjedisin e Këshillit Bashkiak, në prezencë vetëm të anëtarëve të Komisionit Disiplinor. Në kuadrin e detyrimit që komisioni disiplinor ka, për sa i përket hetimit të çdo pretendimi të ngritur, si edhe funksionit që ushtron subjekti një detyrë që përfshin përgjegjësi të drejtpërdrejtë në ruajtjen e Sigurisë së qytetareve, përfaqësimit e autoritetit të institucionit në terren, dhe besueshmërisë që kërkon ky funksion, testi toksikologjik, është vlerësuar një zgjedhje proporcionale, si forma më e përshtatshme. Trajtimi i barabartë bëhet kur subjektet ndodhen në të njëjtat kushte objektive, por në rastin e mësipërm pretendimi ka rezultuar vetëm për z. E.Z. Theksojmë se personi nuk është detyruar ta kryejë testin toksikologjik dhe është respektuar zgjedhja e tij.

4. Pretendimi i diskriminimit lidhur me barazinë në punë.

Struktura organike e Policisë Bashkiake është miratuar me Urdhrin nr. 11345/1, datë 23.03.2023, i ndryshuar me Urdhrin nr. 37271/1, datë 27.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Bashkia Tiranë përbëhet nga 24 njësi administrative dhe 3 lagje, gjithsej 27 njësi.

Me Urdhrin nr. 1543, datë 15.08.2025, të Kryetarit të Bashkisë, për nevoja të punës në Policinë Bashkiake, z. E.Z është transferuar nga Drejtoria e Sigurisë së Objekteve dhe është emëruar Inspektor në Sektorin Jug-Perëndim, pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit.

Në Sektorin Jug-Perëndim, sipas strukturës së miratuar me urdhrin e sipërcituar, janë në organikë 10 inspektorë dhe 9 punonjës policie.

Planifikimi i shërbimit pasqyrohet në urdhrin e ditës të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit dhe në Librin e Shërbimit 24-orësh të Sektorit Jug-Perëndim, ku përcaktohet mënyra dhe vendi i ushtrimit të detyrës nga shërbimet e Policisë Bashkiake.

– Lidhur me pretendimin për mospasjen e një ndihmës polici gjatë periudhës si inspektor njësie theksojmë se ka njësi administrative që, për shkak të strukturës organike, nuk mbulohen njëkohësisht me inspektor dhe punonjës policie ndihmës. Konkretisht, në Njësinë Administrative nr. 14, ku ka ushtruar detyrën z. E.Z, janë në organikë 2 inspektorë dhe 1 punonjës policie, të cilët ushtrojnë detyrën në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Po ashtu, ka njësi të tjera që, për shkak të organikës së miratuar, nuk mbulohen me punonjës policie ndihmës.

Në mbështetje të sa më sipër, ju vëmë në dispozicion urdhrat e ditës të datave 21.08.2025; 29.08.2025; 11.09.2025; 25.09.2025; 18.10.2025; 30.10.2025; 04.11.2025, si dhe fletë të përzgjedhura në mënyrë rastësore nga Libri i Planifikimit të Shërbimit të Sektorit Jug-Perëndim nr. 789, regjistruar me datë 30.04.2025, për datat 01.09.2025; 12.09.2025; 24.09.2025; 15.10.2025; 31.10.2025. Këto dokumente provojnë se edhe në Sektor të tjerë ka pasur planifikim shërbimi vetëm me një inspektor, pa praninë e një punonjësi policie ndihmës.

Gjatë ushtrimit të detyrës, Inspektori E.Z ka shfaqur në vazhdimësi probleme në komunikim, paraqitje në punë, mbajtjen e uniformës, mosraportim për detyrat e ngarkuara, si dhe moszbatim të urdhrave të ligjshëm.

Konkretisht, me datë 10.10.2025, i planifikuar në shërbim nga ora 07:00 deri në orën 15:00 në Njësinë Administrative nr. 14, është konstatuar në orën 11.00 me uniformë të deformuar dhe me pantallona civile, në kundërshtim me rregulloren përkatëse. Pas këtij konstatimi, nuk ka zbatuar urdhrin e eprorit për të paraqitur raport shërbimi, duke konsumuar kështu edhe shkelje për moszbatim të urdhrit të ligjshëm.

Gjithashtu, me datë 14.10.2025, Përgjegjësi i Sektorit Jug-Perëndim ka raportuar pranë Sallës së Drejtimit dhe Koordinimit se, në orën 06:58, inspektori në fjalë kishte njoftuar se ndodhej në Kombinat, pranë shkollës “Betim Muça”. Nga kontrolli i kryer në orën 07:02 rezultoi se ai kishte raportuar pa u paraqitur fare në shërbim. Ky fakt është pasqyruar në komunikatën 24-orëshe të Policisë Bashkiake për datat 14.10.2025-15.10.2025.

Me datë 04.11.2025, me shkresën nr. 38015, është dërguar informacion pranë Komisionit Disiplinor mbi shkeljet e konstatuara dhe është kërkuar fillimi i procedurës disiplinore, për shkak të rasteve të përsëritura të shkeljes së rregullave në punë dhe shërbim, si dhe të moszbatimit të urdhrave të eprorit. Në vijimësi, punonjësi ka shfaqur probleme në marrëdhëniet me eprorët, me komunikim jo etik, të acaruar dhe joprofesional.

Me qëllim marrjen e masave parandaluese për shmangien e çdo situate apo incidenti brenda sektorit, i është propozuar Kryetarit të Bashkisë transferimi dhe emërimi i tij si Inspektor në Sektorin e Grupeve të Mbështetjes, pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit. Me datë 11.11.2025, pas daljes së urdhrit përkatës të Kryetarit nr. 38719, datë 10.11.2025, ai është emëruar në këtë detyrë.

Në përfundim, sqarojmë se planifikimi i shërbimit është realizuar në përputhje me strukturën organike të miratuar dhe mbi bazën e nevojave konkrete operationale, pa asnjë trajtim të diferencuar apo diskriminues ndaj punonjësit në fjalë.

5. Pretendimi i diskriminimit lidhur me mohimin e të drejtave gjatë seancave.

Pretendimi se nuk është lejuar për tu njohur me provat - Bazuar në kërkesën e z. E.Z, me nr. E-24325, datë 23.12.2025, i është dërguar dokumentacioni i kërkuar me anë të shkresës “Kthim përgjigje”, nga institucioni i Bashkisë Tiranë, me nr. E-24325/1, datë 20.01.2026, dërguar nëpërmjet postës me datë 21.01.2026. Gjithashtu, gjatë seancave provat janë debatuar në kontradiktoritet me palët, ndaj për sa kohë që z. E.Z ka shprehur kundërshtimet e tij, ka qenë i informuar dhe gjatë shqyrtimit të seancave, se mbi çfarë ishte duke kundërshtuar,

Pretendimi i shkeljes të së drejtës së regjistrimit të seancës - Komisioni disiplinor funksionin në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ku ligji ka përcaktuar se procesverbali mbahet me shkrim.

6. Pretendimi i diskriminimit lidhur me pagën.

Ju bëjmë me dije se z. E.Z ushtron funksionin inspektor pranë Policisë Bashkiake. Niveli i pagës së tij përcaktohet në zbatim të VKB nr. 133, datë 22.12.2023, lidhja nr. 3, pika 7, sipas së cilës për kategorinë “Inspektor i Policisë Bashkiake” është parashikuar pagë bazë në masën 81.800 lekë. Kjo kategori përfshin punonjës me arsim të nivelit bachelor, kriter që përmbushet si nga subjekti në fjalë, ashtu dhe nga punonjësit e tjerë të së njëjtës kategori, për rrjedhojë paga e tij përbëhet vetëm nga paga bazë e përcaktuar sipas dispozitave të sipërcituara .

7. Pretendimi diskriminues dhe jo ligjor mbi ngritjen e një komisioni disiplinor pas një tjetri brenda një muaji.

Bazuar në dokumentet e administruara nga Bashkia Tiranë, është ngritur vetëm një urdhër nga Kryetari për Komision Disiplinor ndaj z. E.Z”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet e-mail-it datë 05.03.2026, është njohur me përgjigjen e Bashkisë Tiranë.

Në kundërshtim të përgjigjes të Bashkisë Tiranë, ankuesi me email-in datë 09.03.2026, në mes të tjerash ka informuar se: “Në lidhje me pretendimin e institucionit se unë atë ditë kam qenë pushim kjo nuk përbën fakt apo argument që nuk është kërkuar pjesëmarrja në tubim/protestë.

Pjesëmarrja e punonjësve në aktivitete politike justifikohet me faktin se kanë qenë “në ditë pushimi”, dëshiroj të parashtroj sa vijon:

Bazuar në Ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, ligji i punonjësit të policisë mbart detyrimin për të mbetur i paanshëm politikisht në çdo kohë dhe ja ndalon pjesëmarrjen në çdo aktivitet politik. Ligji nuk bën dallim nëse punonjësi është në shërbim apo në pushim; pjesëmarrja në tubime politike apo rrethimi i institucioneve të rëndësisë së veçantë (si SPAK apo GJKKO) përbën shkelje të rëndë të etikës dhe kuadrit ligjor që rregullon funksionimin e kësaj strukture.

Vendimi i formës së prerë i Gjykatës, të cilën e kam dërguar me postë, unë personalisht në rrugë postare por përsos kësaj Bashkia si institucion ka qenë palë në proces dhe gjykata ka faqe zyrtare konform akteve ligjore në fuqi që nxjerr njoftimet, publikimet dhe vendimet!

Kërkesa e Komisionit për kryerjen e një testi toksikologjik, e bazuar vetëm në “dyshime të arsyeshme” të cituara nga eprori (Drejtori i Kontrollit të Territorit), përbën një shkelje të rëndë procedurale.

Arsyetimi për “shmangien e incidenteve” është tërësisht i pabazuar në prova konkrete. Gjatë një karriere rreth 10-vjeçare pranë këtij institucioni, nuk ekziston asnjë masë disiplinore, procesverbal apo ankesë apo akuzë zyrtare që të vërtetojë se unë jam përfshirë në konflikte me kolegët apo akte korruptive. Sipas Kodit të Procedurës Administrative, çdo vendim i organit publik duhet të bazohet në fakte të provuara dhe jo në supozime apo informacione të pakonfirmuara.

Pretendimi se lëvizja ime u bë për “parandalim sherresh” është i pabesueshëm dhe i diskredituar nga faktet e fundit. Pak kohë pas transferimit tim, në ambientet e zyrave të Policisë Bashkiake kanë ndodhur incidente dhune fizike mes punonjësve të institucionit të pasqyruara edhe në platformat mediatike.

Pretendimi i institucionit se e drejta ime për t’u njohur me dokumentacionin është respektuar përmes shkresës me nr. E-24325/1, datë 20.01.2026, është ligjërisht i pabazuar dhe i qëllimshëm për këto arsye:

Vonesa Dy-Mujore: Procedura administrative ndaj meje ka filluar me mbledhjen e parë të Komisionit më datë 02.12.2025. Ndërkohë, aksesin në dosje e kam siguruar vetëm me datë 20.01.2026. Kjo do të thotë se për rreth 50 ditë, komisioni ka vijuar procedurën pa më dhënë mundësinë të njoh faktet mbi të cilat bazohej akuza.

Gjithashtu, bëj me dije se i gjithë procesi ka pasur një qëllim të paracaktuar: largimin tim nga puna. Kjo vërtetohet nga informacioni i shkresës me nr. 38025, datë 04.11.2025, që Policia Bashkiake i ka dërguar, Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm, Burimeve Njerëzore, Komisionit të Disiplinës, ku në vend të një relacioni objektiv, kërkohet drejtpërdrejt ndëshkimi im më i rrepte që ekziston!

Në bazë të shkresave që ju kam dërguar më parë vërtetohet qartë se sa herë jam thirrur në komisione brenda 2 muajve, pa marrë parasysh gjendjen time social shoqërore me fëmijë të porsalindur dhe me fëmijën tjetër të mitur dhe me pleqëri dhe me një rrogë diskriminuese në raport me pjesën tjetër të efektivit. Aq më diskriminues fakti që rroga e këtij muaji ishte 50-mijë lek të reja, pa më vënë fare në dijeni për këtë fakt apo arsye dhe pa më njoftuar konform kodit të procedurës administrative dhe në kundërshtim me kontratën e punës”.

Me email-in datë 27.03.2026, ankuesi ka dërguar për dijeni shkresën drejtuar Bashkisë Tiranë, në të cilën në mes të tjerash ka informuar Bashkinë se: “Në cilësinë e punëmarrësit pranë institucionit të Policisë Bashkiake, Bashkia Tiranë, nëpërmjet kësaj shkrese, ju njoftoj zgjidhjen e menjëhershme dhe të parëvokueshme të marrëdhënies sime të punës, për shkaqe të justifikuara, bazuar në nenin 153, të Kodit të Punës. Ky vendim vjen si pasojë e rrethanave të rënda dhe shkeljeve sistematike të kryera nga ana e punëdhënësit, të cilat kanë shkatërruar përfundimisht parimin e mirëbesimit dhe e bëjnë të pamundur vazhdimin e mëtejshëm të punës”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 132/3, datë 09.04.2026 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 22.04.2026, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesi z. E.Z dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueseve me autorizim nr. 14141, datë 16.04.2026, të Bashkisë Tiranë, z. S.I, znj. A.D dhe znj. E.M.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me email me KMD-në, dhe në mes të tjerash deklaroi se nga transferimi paga e tij ishte ulur me 13.000 lekë.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë, i qëndruan të njëjtave parashtime që kishin bërë të njohur gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, dhe në mes të tjerash deklaruan se: *“Shërbimi i punonjësve të policisë bashkiake organizohet me tre turne sipas grafikut të shërbimit dhe punonjësit lajmërohen 24 orë përpara. Referuar librit të shërbimit nr. 782, datë 27.01.2025, ankuesi me datë 12.02.2025 ka qenë pushim shërbimi.*

Me urdhrin datë 15.08.2025 të Kryetarit të Bashkisë, për nevoja të punës ankuesi është transferuar nga Drejtoria e Sigurisë së Objekteve në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit, pra 6-muaj pas datës që ankuesi pretendon se i ka ardhur transferimi sepse nuk ka marrë pjesë në ngjarjen e datës 12.02.2025. Transferimi ka qenë lëvizje paralele dhe i vetmi ndryshim ishte se në Drejtorinë e Sigurisë së Objekteve puna është me tre turne ndërsa në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit puna është vetëm me një turn dhe kjo është arsyeja se ka marrë më pak lekë sepse nuk paguhen orë shtesë për turnin e parë.

Drejtorja e Kontrollit të Territorit ka katër sektorë dhe në sektorin jug-perëndim në organikë janë 10 inspektorë dhe 9 policë. Brenda drejtorisë planifikimi dhe lëvizja e personelit për nevoja pune bëhet nga drejtori me libër shërbimi 24-orësh dhe pa emërim. Lidhur me nevojat e shërbimit informoj se nuk është vetëm ankuesi që ka punuar si inspektor i vetëm por janë disa për shkak të mungesave të personelit në organikë dhe kemi sjellë disa shembuj nga libri i shërbimit që ka disa inspektorë që kanë qenë vetëm në shërbim.

Nisur nga problematikat, konfliktet dhe mënyrën e komunikimit të ankuesit dhe për të shmangur acarimet ankuesi është transferuar nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit tek Sektori i grupit të gatshëm, kështu që gjatë kësaj periudhe ankuesi ka pasur vetëm dy lëvizje me urdhër të kryetarit të cilat nuk i ka kundërshtuar.

Në datë 10.10.2025 ankuesit i është kërkuar raport shërbimi dhe nuk është paraqitur, ndërkohë që kishte mundësi të paraqitej dhe të kundërshtonte shkëljen e konstatuar dhe ankuesi nuk e mohon se i është kërkuar raporti i shërbimit.

Lidhur me kërkesën për regjistrimin e seancës të Komisionit të Disiplinës informoj se janë caktuar dy sekretare teknike për të mbajtur procesverbalin e seancës, pasi nuk disponojmë infrastrukturën e duhur për regjistrimin e seancës dhe në datë 21.01.2026 ankuesit i janë vënë në dispozicion të gjitha provat që dispononte komisioni.

Kërkesa e komisionit për të bërë testin toksikologjik për shkak të konsumit të alkolit është bazuar mbi dyshimin e arsyeshëm referuar materialit fillestar të bërë nga Policia Bashkiake, por ankuesi nuk është detyruar për të bërë testin.

Paga e punonjësve të policisë bashkiake rregullohet sipas VKB nr. 133 datë 22.12.2023, e cila parashikon që ankuesi paguhet sipas nivelit të diplomës që është bachelor dhe nuk parashikon pagesë për vjetërsi në punë për këtë kategori”.

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë z. S.I me email-in datë 24.04.2026, në mes të tjerash informoi se: *“Në lidhje me njoftimin për vendimin e Komisionit të Disiplinës për mbajtjen e 1/4 të pagës për 3 muaj, sqarojmë se z. E.Z ka qenë prezent në seancë në momentin e marrjes së vendimit dhe ka nënshkruar procesverbalin përkatës të mbajtur për këtë rast (datë 27.01.2026).*

Sa i përket relacionit mbi arsyet e lëvizjes së ankuesit. Me shkresën nr. 3098, datë 12.08.2025, “Relacion për lëvizje punonjësi” është kërkuar se nisur nga nevojat e punës në Sektorin Jug-Perëndim dhe nga kërkesat për shtimin e kontrollit në terren, kryesisht në administrimin e hapësirave publike, rritjen e pranisë në terren, përballimin e volumit të shtuar të punës, propozohet transferimi i punonjësit E.Z, në këtë sektor, në të njëjtën detyrë. Transferimi i tij kërkohet për faktin se punonjësi ka punuar më parë në këtë sektor dhe ka eksperiencën e nevojshme për përmbushjen e detyrave. Gjithashtu, mosha e tij konsiderohet e përshtatshme për përballimin e kërkesave të punës në terren.

Paga e z. E.Z është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 22.12.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 21, datë 17.03.2023 të Këshillit Bashkiak ‘Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë’”. Bashkëlidhur paga e ankuesit dhe kolegëve me nivel arsimor bachelor: E.M, L.T dhe E.Q, të cilët kanë pothuajse paga të njëjta.

Në lidhje me shkresën nr. E-4315, datë 10.03.2026, ju sqarojmë se ndalesa e pagës është kryer bazuar në kërkesën që Drejtoria e Administrimit të Brendshëm i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar me shkresën nr. 2078/2, datë 12.02.2026, në zbatim të vendimit të Komisionit Disiplinor nr. 2078/1, datë 05.02.2026”.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3/1, parashikon se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit*

disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në karakteristika të veçanta të punonjësit.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe marrjen e masës disiplinore;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se:

Me Urdhrin nr. 20547, datë 23.05.2017, z. E.Z është emëruar në detyrën Inspektor në Policinë e Bashkisë së Tiranës dhe po atë ditë është lidhur dhe kontrata e punës.

Me Urdhrin nr. 12481, datë 29.03.2023, z. E.Z është emëruar në detyrën Inspektor i Policisë Bashkiake në Sektorin e Patrullave, në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit.

Me Urdhrin nr. 1800, datë 25.06.2024, z. E.Z është liruar nga detyra Inspektor në Sektorin e Patrullave, në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit dhe emërohet në pozicionin Inspektor për Sigurinë e Objekteve dhe Ceremonialit, në Drejtorinë e Sigurisë së Objekteve dhe Ceremonialit, në Policinë Bashkiake.

Me Urdhrin nr. 1543, datë 15.08.2025 të Kryetarit të Bashkisë, z. E.Z është transferuar nga Drejtoria e Sigurisë së Objekteve dhe është emëruar Inspektor në Sektorin Jug-Perëndim, në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit.

Me shkresën nr. 38025, datë 04.11.2025, Policia Bashkiake, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Drejtimit dhe Koordinimit, ka përcjellë në Bashkinë Tiranë informacion lidhur me konstatimet e shkeljeve disiplinore ndaj z. E.Z.

Me Urdhrin nr. 1987, datë 10.11.2025, të Kryetarit të Bashkisë, z. E.Z është transferuar në pozicionin Inspektor në Sektorin e Grupeve Mbështetëse, pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit.

Me Urdhrin nr. 38025/1, datë 14.11.2025, Bashkia Tiranë ka ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa me njoftimin nr. 38025/2, datë 21.11.2025, ankuesi është njoftuar për procedurën.

Me datë 03.12.2025, është zhvilluar seanca e parë e Komisionit Disiplinor, ku janë shqyrtuar pretendimet lidhur me moszbatimin e urdhrave, mosparaqitjen në mbledhje, problematikat me

shërbimin dhe çështje të tjera të ngritura nga eprorët. Ankuesi ka paraqitur kundërshtimet e tij dhe sipas dokumentacionit, ka referuar edhe vendimin gjyqësor të datës 02.12.2025.

Me datë 15.01.2026, ankuesi është njoftuar për vijimin e ecuresë disiplinore, pasi seanca e mëparshme e planifikuar nuk ishte zhvilluar për shkak të lejes së justifikuar të ankuesit. Procedura ka vijuar me seanca të tjera në datat 22.01.2026, 23.01.2026 dhe 27.01.2026, ku ankuesi ka qenë i pranishëm dhe ka paraqitur qëndrimet e tij.

Me Vendimin nr. 2078/1, datë 05.02.2026, Komisioni Disiplinor ka vendosur ndaj ankuesit masën disiplinore “mbajtje e 1/4 të pagës së plotë për tre muaj”, në zbatim të nenit 44, pika 1, shkronja “b/i”, të ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”. Bashkia Tiranë ka sqaruar se ankuesi ka qenë prezent në seancën e datës 27.01.2026, në momentin e marrjes së vendimit dhe ka nënshkruar procesverbalin përkatës.

Ankuesi me shkresën datë 20.03.2026 drejtuar Bashkisë Tiranë ka njoftuar zgjidhjen e menjëhershme dhe të parevokueshme të marrëdhënies së punës.

Në rastin konkret, pretendimet e ankuesit për trajtim të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë lidhen kryesisht me katër aspekte: lëvizjet/transferimet në detyrë; procedurën e ecuresë disiplinore dhe masës disiplinore; kërkesës për kryerjen e testit toksikologjik; si dhe llogaritjen e pagës dhe të vjetërsisë në punë.

Ankuesi ka pretenduar se është lëvizur disa herë nga pozicioni i punës brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe se këto lëvizje nuk janë kryer për nevoja objektive të institucionit, por si formë presioni, ndëshkimi dhe trajtimi të pafavorshëm ndaj tij. Konkretisht, ankuesi pretendon se është lëvizur nga Drejtoria e Sigurisë së Objekteve në Drejtorinë e Kontrollit të Territorit (datë 15.08.2025), më pas është planifikuar si inspektor në njësi të ndryshme administrative dhe në vijim, është kaluar në Sektorin e Grupeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit. Ai pretendon gjithashtu se gjatë periudhës kur ka ushtruar detyrën si inspektor njësie nuk i është caktuar punonjës policie ndihmës, ndryshe nga punonjës të tjerë, duke u vendosur në pozitë të pabarabartë.

Në analizimin e këtij pretendimi, Komisioneri vëren se marrëdhëniet e punës së punonjësve të Policisë Bashkiake rregullohen nga ligji nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake” dhe për çështje që nuk rregullohen posaçërisht nga ky ligj, nga Kodi i Punës. Neni 11 i ligjit nr. 89/2022 parashikon se marrëdhëniet e punës së drejtuesit dhe punonjësve të tjerë të Policisë Bashkiake rregullohen sipas këtij ligji dhe Kodit të Punës. Nga ana tjetër, neni 1 i të njëjtit ligj përcakton se ligji rregullon misionin, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Policisë Bashkiake, marrëdhëniet e punës së punonjësit të Policisë Bashkiake, si dhe masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në komunitet.

Në këtë kuadër, vlerësimi i ligjshmërisë dhe i karakterit diskriminues ose jo të lëvizjeve të ankuesit nuk mund të bëhet i shkëputur nga natyra e veçantë e Policisë Bashkiake si strukturë administrative, operative dhe hierarkike e bashkisë. Neni 5 i ligjit nr. 89/2022 përcakton se Policia Bashkiake është strukturë administrative e bashkisë dhe ushtron veprimtarinë në territorin e bashkisë përkatëse,

ndërsa neni 7 parashikon se Policia Bashkiake organizohet në strukturë organizative hierarkike në nivel drejtorie ose sektori dhe se Kryetari i Bashkisë miraton strukturën dhe organikën e saj.

Po kështu, neni 8 i ligjit nr. 89/2022 i njuh Kryetarit të Bashkisë përgjegjësinë për të kontrolluar dhe analizuar veprimtarinë e Policisë Bashkiake, si dhe për të siguruar mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj. Ndërsa neni 9 i këtij ligji përcakton kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake, ndër të cilat sigurimin e zbatimit të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, parandalimin, konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative në territorin e juridiksionit të saj, marrjen e masave për rendin dhe sigurinë në komunitet, bashkërendimin e masave për aktivitetet që zhvillohen në territorin e bashkisë, ruajtjen e hapësirave publike dhe mbështetjen e strukturave të tjera bashkiake.

Nga këto dispozita rezulton se Policia Bashkiake, për shkak të misionit të saj, ka nevojë për organizim fleksibël të shërbimit, për planifikim të punonjësve sipas territorit, sektorëve, ngarkesës në terren, aktiviteteve publike, problematikave të hapësirave publike dhe prioriteteve të përditshme të institucionit. Për rrjedhojë, ndryshimi i vendit konkret të ushtrimit të shërbimit, planifikimi në një njësi administrative të caktuar, apo lëvizja brenda të njëjtës drejtori ose strukturë të Policisë Bashkiake, nuk përbën automatikisht trajtim të padrejtë, të pafavorshëm ose të pabarabartë.

Në të njëjtën linjë, neni 21 i Kodit të Punës përcakton se kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe se ajo duhet të përmbajë, ndër të tjera, vendin e punës, përshkrimin e përgjithshëm të punës, elementët përbërës të pagës, kohën normale javore të punës dhe llojet e procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive. I njëjti nen parashikon se kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit, kundrejt pagesës.

Ky parashikim është i rëndësishëm për rastin konkret, pasi tregon se marrëdhënia e punës përfshin, nga njëra anë, të drejtën e punëmarrësit për të mos iu ndryshuar në mënyrë të njëanshme elementët thelbësorë të kontratës në dëm të tij, por, nga ana tjetër, edhe të drejtën e punëdhënësit për të organizuar procesin e punës dhe për të dhënë urdhra pune brenda kuadrit të funksionit, strukturës dhe përshkrimit të përgjithshëm të detyrës. Në rastin e Policisë Bashkiake, ky kuadër organizimi duhet lexuar së bashku me ligjin e posaçëm nr. 89/2022, i cili e koncepton Policinë Bashkiake si strukturë hierarkike, me funksione operative dhe territoriale.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se struktura organike e Policisë Bashkiake të Bashkisë Tiranë është miratuar me Urdhrin nr. 11345/1, datë 23.03.2023, i ndryshuar me Urdhrin nr. 37271/1, datë 27.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Bashkia Tiranë ka sqaruar se territori administrativ përbëhet nga 24 njësi administrative dhe 3 lagje, gjithsej 27 njësi, çka kërkon organizim të shërbimit në funksion të mbulimit territorial dhe nevojave të kontrollit në terren.

Nga aktet rezulton se me Urdhrin nr. 1543, datë 15.08.2025, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. E.Z është transferuar nga Drejtoria e Sigurisë së Objekteve dhe është emëruar Inspektor në Sektorin Jug-Perëndim, pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit. Sipas shkresës së Bashkisë Tiranë, ky transferim është bërë “për nevoja të punës në Policinë Bashkiake”.

Referuar shkresës nr. 28205, datë 12.08.2025 të Policisë Bashkiake, “*Propozim për lëvizje në detyrë*”, rezulton se Policia Bashkiake për nevoja të shërbimit ka propozuar për lëvizje dhe emërim në detyrë, ankuesin dhe tre punonjës të tjerë: E.Xh, P.Z dhe R.H.

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë ka sqaruar më tej se lëvizja e ankuesit është mbështetur në shkresën nr. 3098, datë 12.08.2025, “*Relacion për lëvizje punonjësi*”. Sipas këtij relacioni, lëvizja është propozuar për shkak të nevojave të punës në Sektorin Jug-Perëndim, kërkesave për shtimin e kontrollit në terren, administrimit të hapësirave publike, rritjes së pranisë në terren dhe përballimit të volumit të shtuar të punës. Në relacion është theksuar gjithashtu se ankuesi kishte punuar më parë në këtë sektor dhe kishte eksperiencën e nevojshme për përmbushjen e detyrave në atë strukturë.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se transferimi i datës 15.08.2025 nuk rezulton të jetë një akt i paarsyetuar apo arbitrar apo që ka prekur vetëm ankuesin. Transferimi rezulton i formalizuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, pra nga autoriteti që, sipas ligjit nr. 89/2022, miraton strukturën dhe organikën e Policisë Bashkiake dhe kontrollon veprimtarinë e saj. Gjithashtu, lëvizja rezulton e mbështetur në një relacion të mëparshëm administrativ, ku janë përcaktuar arsyet objektive të nevojës për lëvizje. Fakti është që ankuesi është emëruar në të njëjtën detyrë, “Inspektor”, dhe nuk rezulton të ketë pësuar ulje në detyrë, ulje në kategori, ndryshim të natyrës së pozicionit apo përkeqësim formal të statusit të tij funksional.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se është lëvizur katër herë brenda një periudhe të shkurtër, Komisioneri vlerëson se duhet bërë dallimi ndërmjet “transferimit/lëvizjes në detyrë” në kuptimin formal administrativ dhe “planifikimit të shërbimit” në kuptimin operacional të organizimit të përditshëm të punës. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se lëvizjet formale të ankuesit, të kryera me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, janë dy: lëvizja me Urdhrin nr. 1543, datë 15.08.2025, nga Drejtoria e Sigurisë së Objekteve në Sektorin Jug-Perëndim pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit, dhe lëvizja e mëvonshme me Urdhrin nr. 38719, datë 10.11.2025, për emërimin e tij si Inspektor në Sektorin e Grupeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit. Gjithashtu rezulton se ankuesi me urdhër të Kryetarit të Bashkisë është transferuar dhe në datë 25.06.2024 dhe nuk rezulton që ai të ketë kundërshtuar apo të ketë ngritur pretendime për këto transferime.

Ndërkohë, vendosja e ankuesit në Njësinë Administrative nr. 2, më pas në Njësinë Administrative nr. 14, apo në pika të tjera shërbimi, rezulton të jetë pjesë e planifikimit të shërbimit dhe jo transferim formal në një pozicion tjetër pune. Bashkia Tiranë ka sqaruar se planifikimi i shërbimit pasqyrohet në urdhrin e ditës të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit dhe në Librin e Shërbimit 24-orësh të Sektorit Jug-Perëndim, ku përcaktohet mënyra dhe vendi i ushtrimit të detyrës nga shërbimet e Policisë Bashkiake.

Në strukturat me natyrë operative, siç është Policia Bashkiake, vendi konkret i ushtrimit të shërbimit mund të ndryshojë sipas nevojave të ditës, zonës që duhet mbuluar, aktiviteteve publike, ngarkesës në terren, mungesave në organikë apo prioritetet e kontrollit. Kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht ndryshim të marrëdhënies së punës, ndryshim të pozicionit apo transferim në kuptim formal. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit për “katër lëvizje” nuk rezulton i provuar si

katër transferime formale, por si kombinim i dy lëvizjeve me urdhër dhe disa planifikimeve operative të shërbimit.

Lidhur me lëvizjen e dytë formale, nga aktet rezulton se pas problematikave të raportuara gjatë ushtrimit të detyrës, përfshirë komunikimin me eprorët, paraqitjen në shërbim, raportimin e detyrave dhe zbatimin e urdhrave, është propozuar që ankuesi të transferohej në Sektorin e Grupeve Mbështetëse, me qëllim marrjen e masave parandaluese për shmangien e çdo situatë apo incidenti brenda sektorit. Sipas dokumentacionit të administruar, me datë 11.11.2025, pas daljes së Urdhrit nr. 38719, datë 10.11.2025, ankuesi është emëruar në këtë detyrë.

Edhe për këtë lëvizje të dytë, Komisioneri vlerëson se aktet e administruara tregojnë një arsye të shprehur institucionale: shmangien e përshkallëzimit të situatave të tensionuara dhe organizimin më të përshtatshëm të shërbimit. Nga dokumentacioni nuk rezulton që kjo lëvizje të ketë sjellë ulje në detyrë, ndryshim të titullit të pozicionit, ndërprerje të marrëdhënies së punës apo përjashtim të ankuesit nga ushtrimi i funksionit të tij si inspektor. Për rrjedhojë, lëvizja nuk rezulton, në vetvete, si trajtim i pafavorshëm në kuptim të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Sa i përket pretendimit për mospasjen e një punonjësi policie ndihmës gjatë periudhës kur ankuesi ka ushtruar detyrën si inspektor njësie, rezulton se në Sektorin Jug-Perëndim, sipas strukturës së miratuar, janë në organikë 10 inspektorë dhe 9 punonjës policie. Për Njësinë Administrative nr. 14, ku ka ushtruar detyrën ankuesi, rezulton se janë në organikë 2 inspektorë dhe 1 punonjës policie, të cilët ushtrojnë detyrën në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Bashkia ka sqaruar gjithashtu se ka edhe njësi të tjera administrative që, për shkak të strukturës organike, nuk mbulohen njëkohësisht me inspektor dhe punonjës policie ndihmës.

Në mbështetje të këtij qëndrimi, Bashkia Tiranë ka vënë në dispozicion urdhrat e ditës të datave 21.08.2025, 29.08.2025, 11.09.2025, 25.09.2025, 18.10.2025, 30.10.2025, 04.11.2025, etj, si dhe fletë të përzgjedhura nga Libri i Planifikimit të Shërbimit të Sektorit Jug-Perëndim nr. 789, regjistruar me datë 30.04.2025, për datat 01.09.2025, 12.09.2025, 24.09.2025, 15.10.2025 dhe 31.10.2025. Referuar këtyre dokumenteve rezulton se dhe në sektorë të tjerë ka pasur planifikim shërbimi vetëm me një inspektor, si ankuesi, pa praninë e një punonjësi policie ndihmës si: E.H, E.Q, I.V, D.M, L.T, K.C, etj.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit për trajtim të pabarabartë për shkak të mospasjes së një punonjësi policie ndihmës nuk mbështetet nga aktet e administruara. Përkundrazi, dokumentacioni tregon se mënyra e planifikimit të shërbimit ka qenë e lidhur me strukturën organike dhe nevojat konkrete operationale dhe se praktika e shërbimit vetëm me një inspektor nuk është aplikuar ekskluzivisht ndaj ankuesit. Për të provuar trajtim të pabarabartë, ankuesi duhet të tregonte se ndodhej në kushte të njëjta me punonjës të tjerë, por, ndryshe nga ata, vetëm atij i është mohuar polici ndihmës, pa arsye objektive.

Komisioneri thekson se jo çdo lëvizje në detyrë apo ndryshim i vendit konkret të shërbimit përbën trajtim të pafavorshëm. Për të arritur në një konstatim të tillë, duhet të provohet se lëvizja ka sjellë një pasojë negative të matshme për punonjësin, si ulje në pozicion, ulje page, heqje kompetencash, izolim profesional, caktim në detyra jashtë përshkrimit të punës, ose trajtim të ndryshëm në raport me punonjës të tjerë. Në rastin konkret, ankuesi ka vijuar të mbajë funksionin “Inspektor i Policisë

Bashkiake”; nuk rezulton ulje në detyrë; nuk rezulton që lëvizjet të kenë ndryshuar statusin e marrëdhënies së punës; dhe nuk provohet që ai të jetë trajtuar ndryshe nga punonjës të tjerë që ndodheshin në kushte objektivisht të njëjta.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit për trajtim të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë lidhur me lëvizjet/transferimet në detyrë nuk rezulton i provuar. Nga aktet e administruara rezulton se lëvizjet formale janë kryer me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe janë argumentuar me nevoja pune dhe organizimi, ndërsa vendosja e ankuesit në njësi apo pika të ndryshme shërbimi ka qenë pjesë e planifikimit operativ të shërbimit, të pasqyruar në urdhrat e ditës dhe Librin e Shërbimit 24-orësh. Në mungesë të provave se këto veprime janë kryer në mënyrë selektive, arbitrare apo në devijim nga trajtimi i punonjësve të tjerë të së njëjtës kategori, Komisioneri çmon se ankuesi nuk është vendosur në pozitë të padrejtë, të pafavorshme apo të pabarabartë në lidhje me lëvizjet/transferimet në detyrë.

Ankuesi ka pretenduar se procedura e ecurisë disiplinore e zhvilluar ndaj tij nga Bashkia Tiranë/Policia Bashkiake ka qenë e padrejtë, e njëanshme dhe e përdorur si mjet ndëshkimi ndaj tij. Ai ka kundërshtuar shkeljet e konstatuara lidhur me paraqitjen me uniformë të deformuar, mosgjatjen në vendin e shërbimit, mosparaqitjen në shërbim gjatë aktivitetit “Maratona e Tiranës 2025”, si dhe mosparaqitjen në mbledhjen e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit.

Së pari, Komisioneri vëren se marrëdhëniet e punës së punonjësve të Policisë Bashkiake rregullohen nga ligji nr. 89/2022 *“Për Policinë Bashkiake”* dhe nga Kodi i Punës, për aq sa ligji i posaçëm nuk parashikon ndryshe.

Në këtë kuadër, detyrat e punonjësit të Policisë Bashkiake kanë natyrë funksionale, operative dhe publike. Prandaj, respektimi i urdhrave të ligjshëm, paraqitja në vendin e shërbimit, mbajtja e uniformës dhe pjesëmarrja në detyrat e planifikuara nuk janë elementë formalë të parëndësishëm, por garanci për funksionimin e rregullt të strukturës, për zbatimin e akteve të bashkisë dhe për ruajtjen e rendit e sigurisë në komunitet. Neni 9 i ligjit nr. 89/2022 parashikon, ndër të tjera, se Policia Bashkiake siguron zbatimin e akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administrative, bashkërendon masat me Policinë e Shtetit për ruajtjen e rendit në aktivitete që zhvillohen në territorin e bashkisë, si dhe siguron zbatimin e rregullave për përdorimin dhe ruajtjen e hapësirës publike.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se fillimi i ecurisë disiplinore ndaj ankuesit ka nisur me shkresën nr. 38025, datë 04.11.2025, të Policisë Bashkiake, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtimit dhe Koordinimit, me lëndë *“Dërgim informacioni në lidhje me konstatimet e shkeljeve disiplinore të efektivit z. E.Z”*. Bashkëlidhur kësaj shkrese është përcjellë informacioni mbi shkeljet e pretenduara dhe është kërkuar fillimi i procedimit disiplinor. Në dokumentacionin e Bashkisë Tiranë është sqaruar se arsyeja e fillimit të procedurës disiplinore ka qenë shkelja e germave “a”, “c”, “e”, “gj” dhe “j”, pika 1, të nenit 39 të ligjit nr. 89/2022 *“Për Policinë Bashkiake”*, të konstatuara nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Territorit. Mbi këtë bazë është nxjerrë Urdhri i Kryetarit për ngritjen e Komisionit Disiplinor nr. 38025/1, datë 14.11.2025, si dhe njoftimi nr. 38025/2, datë 21.11.2025.

Ligji nr. 89/2022 përcakton në nenin 39 llojet e shkeljeve disiplinore. Sipas kësaj dispozite, ndër shkeljet e rënda disiplinore përfshihen mospërbushja e detyrave, shkelja e përsëritur e rregullave të etikës, moszbatimi i urdhrave të ligjshëm të eprorëve kur kanë sjellë pasoja, paraqitja në detyrë ose shërbim nën efektet e alkoolit ose konsumimi i tij gjatë detyrës, si dhe mospërdorimi i uniformës dhe shenjave dalluese gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj.

Sa i përket pretendimit për paraqitje me uniformë të deformuar, Komisioneri vëren se uniforma e punonjësit të Policisë Bashkiake nuk është element fakultativ ose estetik, por pjesë e identifikimit zyrtar të punonjësit gjatë ushtrimit të detyrës. Neni 46 i ligjit nr. 89/2022 parashikon se punonjësi kryen detyrat e shërbimit me uniformë dhe shenja dalluese të veçanta, se stema dhe shenjat dalluese përdoren në uniformën e Policisë Bashkiake, se uniforma dhe shenjat dalluese përdoren vetëm gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, si dhe se gjatë kryerjes së detyrës punonjësi identifikohet me dokumentin individual të identifikimit.

Në këtë kuptim, mbajtja e uniformës në mënyrë të rregullt është e lidhur drejtpërdrejt me ushtrimin e autoritetit publik, identifikimin e punonjësit përpara qytetarëve, besueshmërinë e strukturës dhe disiplinën e brendshme. Për rrjedhojë, konstatimi i eprorit për paraqitje me uniformë jo të rregullt/deformuar përbën një element që institucioni kishte të drejtë ta vlerësonte në kuadër të sjelljes profesionale dhe disiplinës në shërbim. Vetë ligji nr. 89/2022 e parashikon mospërdorimin e uniformës dhe shenjave dalluese gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj si shkelje disiplinore. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se përfshirja e këtij elementi në informacionin disiplinor nuk rezulton e pabazuar, as nuk tregon, në vetvete, trajtim të padrejtë apo të pabarabartë ndaj ankuesit.

Sa i përket mosgjatjes së ankuesit në vendin e shërbimit, nga dokumentacioni rezulton se, me datë 15.10.2025, z. E.Z kishte raportuar se kishte marrë shërbimin pranë shkollës “Betim Muço”, ndërkohë që nga shefi i tij, i cili ka qenë prezent në seancën e datës 22.01.2026 në cilësinë e dëshmitarit, është pohuar se ankuesi nuk është konstatuar prezent në vendin e detyrës së ngarkuar. Gjithashtu, dhe në dokumentin “Komunikatë mbi ankesat ardhura në sallën operative të Policisë Bashkiake gjatë 24-orëve, datë 14-15.10.2025”, rezulton se në orën 07.22, inspektori I.Sh (përgjegjësi i sektorit) ka raportuar se ankuesi nuk ndodhej në shërbim dhe i është komunikuar që të bëjë raport shërbimi për situatën e raportimit pa qenë në shërbim.

Komisioneri vlerëson se në rastin e një punonjësi të Policisë Bashkiake, vendi i shërbimit është element i përbushjes së detyrës. Nëse punonjësi raporton marrjen e shërbimit në një pikë të caktuar, por nuk gjendet në atë vend gjatë kontrollit, kjo rrethanë krijon dyshim të arsyeshëm për mospërbushje të detyrës ose moszbatim të planifikimit të shërbimit. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se institucioni kishte bazë objektive për ta administruar këtë fakt si pjesë të procedimit disiplinor dhe për ta shqyrtuar nëse ai përbënte mospërbushje të detyrave apo moszbatim të urdhrave të eprorit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 89/2022.

Sa i përket mosparaqitjes në shërbim gjatë aktivitetit “Maratona e Tiranës 2025”, nga aktet rezulton se me datë 19.10.2025, gjatë aktivitetit “Maratona Tirana 2025”, punonjësi nuk është paraqitur në shërbim, fakt i cili nuk është kundërshtuar nga ankuesi. Në përgjigjen e Bashkisë Tiranë saktësohet se, për shkak të këtij aktiviteti, ishin njoftuar të gjithë punonjësit se lejet anuloheshin dhe se duhej

të ishin të disponueshëm në shërbim. Për këtë pretendim janë paraqitur si prova Urdhri i brendshëm nr. 4375, datë 14.10.2025, *“Për anulimin e lejes vjetore”*, si dhe plani i masave nr. 4376, datë 14.10.2025, *“Për zbatimin e masave në mbarëvajtjen e aktivitetit ‘Maratona Fun Run’ dhe ‘Maratona e Tiranës 2025’”*, që do të zhvilloheshin në datat 18.10.2025 dhe 19.10.2025.

Në vlerësimin e Komisionerit, fakti që data 19.10.2025 ka qenë ditë e diel ose ditë pushimi, siç ka pretenduar ankuesi gjatë procedimit, nuk e përjashton automatikisht detyrimin për paraqitje në shërbim, nëse punonjësi është njoftuar me akt të brendshëm për anulimin e lejes dhe për nevojën e angazhimit në shërbim për shkak të një aktiviteti publik. Policia Bashkiake, sipas nenit 9 të ligjit nr. 89/2022, ka detyrë të bashkërendojë masa për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në raste aktiviteteve që zhvillohen në territorin e bashkisë. Për rrjedhojë, planifikimi i punonjësve për një aktivitet të tillë lidhet me nevoja objektive të shërbimit dhe me funksionin publik të strukturës. Në këto kushte, mosparaqitja në shërbim në një ditë të tillë përbënte rrethanë të mjaftueshme për t’u vlerësuar nga Komisioni Disiplinor, pa u konsideruar automatikisht si veprim i padrejtë apo i diferencuar ndaj ankuesit.

Sa i përket mosparaqitjes në mbledhjen e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit, nga dokumentacioni rezulton se me datë 29.10.2025, në orën 15:45, në mbledhjen e kryer me stafin e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit, z. E.Z nuk ka qenë i pranishëm. Bashkia Tiranë ka sqaruar se njoftimi ishte kryer me mesazh në celular në grupin e drejtorisë dhe se nga ana e ankuesit nuk ishte dhënë asnjë koment.

Në lidhje me këtë fakt, ankuesi ka deklaruar gjatë seancës disiplinore se mbledhja ishte zhvilluar përtej orarit të tij zyrtar të punës për atë ditë. Megjithatë, Komisioneri vëren se në strukturat me natyrë operative dhe hierarkike, si Policia Bashkiake, pjesëmarrja në mbledhjet e thirrura nga eprorët, veçanërisht kur lidhen me organizimin e shërbimit, raportimin e detyrave dhe mbarëvajtjen e punës në terren, përbën pjesë të detyrimit funksional të punonjësit. Nëse punonjësi kishte pengesë objektive për pjesëmarrje, ai kishte mundësinë të njoftonte eprorin ose të paraqiste shpjegim. Nga aktet rezulton se nuk është dhënë asnjë koment apo njoftim paraprak nga ana e tij. Kjo rrethanë e bën të arsyeshëm shqyrtimin e këtij fakti nga Komisioni Disiplinor si element i moszbatimit të urdhrave të eprorit ose mospërmbushjes së detyrës.

Në këtë kuadër, Komisioneri vlerëson se shkeljet e konstatuara nuk kanë qenë të shkëputura nga detyra funksionale e ankuesit, por lidhen drejtpërdrejt me elementë të marrëdhënies së punës në Policinë Bashkiake: paraqitja me uniformë të rregullt, prania në vendin e shërbimit, zbatimi i planifikimit për aktivitete publike dhe pjesëmarrja në komunikimet/mbledhjet e thirrura nga eprorët. Këto elementë janë të lidhur me parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, kontrollit dhe llogaridhënies, të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 89/2022.

Nga pikëpamja procedurale, neni 40 i ligjit nr. 89/2022 parashikon se masat disiplinore merren nga organi disiplinor sipas një procedure transparente, e cila i garanton punonjësit të drejtën për t’u informuar, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative. Për shkelje të rënda disiplinore, masa merret nga Komisioni i Disiplinës, i cili përbëhet nga pesë anëtarë dhe ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Komisioni mblidhet,

organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.

Në rastin konkret, nga aktet rezulton se procedura disiplinore është zhvilluar nga Komisioni Disiplinor i ngritur me Urdhrin nr. 38025/1, datë 14.11.2025 dhe ankuesi është njoftuar me njoftimin nr. 38025/2, datë 21.11.2025. Gjatë shqyrtimit, ankuesi ka paraqitur qëndrimet e tij, ka kundërshtuar pretendimet, ka shpjeguar se mbledhja e datës 29.10.2025 ishte përtej orarit të punës, ka pretenduar se data 19.10.2025 ishte ditë e diel/pushimi zyrtar, si dhe ka paraqitur relacion gjatë procedimit disiplinor. Kjo tregon se procedura nuk është zhvilluar në mungesë të tij apo pa i dhënë mundësi për mbrojtje, por se pretendimet dhe kundërshtimet e tij janë administruar dhe vlerësuar nga organi disiplinor.

Në lidhje me funksionimin e Komisionit Disiplinor si organ kolegjial, ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”* parashikon se kryetari i organit kolegjial drejton mbledhjen, diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta. Po ky ligj parashikon se organi kolegjial merr vendime vetëm për çështje të përfshira në rendin e ditës, se mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve, se vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë, si dhe se në çdo mbledhje mbahet procesverbal ku pasqyrohen data, vendi, anëtarët pjesëmarrës, çështjet e diskutuara dhe vendimet e marra.

Nga dokumentacioni i Bashkisë Tiranë rezulton se nuk është ngritur më shumë se një Komision Disiplinor ndaj ankuesit për këtë procedim, por vetëm një urdhër nga Kryetari i Bashkisë për ngritjen e Komisionit Disiplinor. Aktet e mëvonshme janë njoftime, seanca dhe procesverbale në vijim të së njëjtës procedurë disiplinore. Për rrjedhojë, pretendimi se ndaj ankuesit janë ngritur disa komisione disiplinore brenda një periudhe të shkurtër nuk mbështetet nga dokumentacioni i administruar.

Në përfundim të procedurës, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar se masa disiplinore e parashikuar në nenin 44, pika 1, shkronja “b/i”, të ligjit nr. 89/2022, *“mbajtje deri në 1/4 e pagës së plotë për një periudhë deri në tre muaj”*, ishte proporcionale me shkeljet e kryera dhe duhej konsideruar si mundësi reflektimi për korrigjimin e sjelljes dhe rifitimin e besimit ndaj eprorëve. Neni 44 i ligjit nr. 89/2022 e parashikon shprehimisht këtë masë si masë disiplinore për shkelje të rënda, ndërsa përcakton se marrja e masës bazohet në shkallën e pakujdesisë, shpeshtësinë e kryerjes së shkeljes, rrethanat e kryerjes, mundësinë e ardhjes së pasojave dhe dëmin e shkaktuar nga shkelja.

Komisioneri vlerëson se, në këtë rast, procedimi disiplinor nuk rezulton të jetë nisur pa bazë faktike apo jashtë detyrimeve funksionale të punonjësit. Shkeljet e konstatuara lidhen me sjellje të përsëritura që kanë të bëjnë me paraqitjen në shërbim, zbatimin e urdhrave, respektimin e uniformës dhe pjesëmarrjen në organizimin e brendshëm të punës. Këto janë elementë të rëndësishëm për një strukturë policore bashkiake, e cila ushtron funksione publike dhe vepron në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me qytetarët.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se nga dokumentacioni i administruar nuk provohet që procedura disiplinore ndaj ankuesit të ketë qenë e pabazuar, selektive apo e përdorur për ta vendosur atë në pozitë të padrejtë, të pafavorshme dhe të pabarabartë. Përkundrazi, rezulton se procedura

është nisur mbi bazën e disa konstatimeve konkrete lidhur me sjelljen në detyrë, është zhvilluar nga organi kompetent, i ngritur sipas ligjit, ankuesit i është dhënë mundësia të dëgjohet dhe të paraqesë shpjegimet e tij, ndërsa masa e vendosur është një nga masat e parashikuara shprehimisht nga ligji nr. 89/2022 *“Për Policinë Bashkiake”*.

Në këto kushte, Komisioneri nuk vlerëson se provohet që ankuesi, z. E.Z, është vendosur në pozita të padrejta, të pafavorshme apo të pabarabarta në lidhje me procedurën e ecurisë disiplinore dhe me shkeljet e konstatuara për uniformën, mosgjetjen në vendin e shërbimit, mosparaqitjen në shërbim dhe mosparaqitjen në mbledhje.

Sa i përket kërkesës për kryerjen e testit toksikologjik, Komisioneri vëren se kjo kërkesë është bërë në kuadër të një pretendimi të pasqyruar në materialin fillestar të eprorit lidhur me dyshime për përdorim alkooli. Bashkia Tiranë ka sqaruar se testi nuk është kryer me detyrim dhe se ankuesit i është respektuar zgjedhja për të mos iu nënshtruar testimit. Kjo rrethanë, e parë në kuadër të procedimit disiplinor dhe funksionit të ankuesit si punonjës i Policisë Bashkiake, nuk rezulton të përbëjë në vetvete trajtim të padrejtë apo të pabarabartë, për sa kohë kërkesa lidhej me një pretendim konkret të ngritur në materialin fillestar dhe nuk rezulton se ankuesi është detyruar ta kryejë testin apo se ndaj tij është marrë masë vetëm për shkak të refuzimit të testimit.

Ankuesi ka pretenduar se paga e tij bruto në masën 81.800 lekë përfaqëson vetëm shtesën për pozicion dhe se, duke qenë se ai zotëron diplomë Bachelor, Bashkia Tiranë duhet t’i llogarisë edhe shtesën për grupin e diplomës në masën 10.000 lekë. Ai ka pretenduar gjithashtu se nuk i llogaritet shtesa prej 2% për çdo vit pune, ndonëse punonjësit e tjerë e përfitojnë këtë shtesë.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se niveli i pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake Tiranë është miratuar me Vendimin nr. 133, datë 22.12.2023, të Këshillit Bashkiak Tiranë, *“Për një ndryshim në vendimin nr. 21, datë 17.03.2023, të Këshillit Bashkiak ‘Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë’”*. Sipas Lidhjes nr. 3 të këtij vendimi, për pozicionin “Inspektor i Policisë Bashkiake”, pika 7, është parashikuar paga në masën 81.800 lekë.

Nga tabela e pagave rezulton se disa pozicione janë të kategorizuara në sistemin “pagë grupi + shtesë pozicioni”, ku parashikohet kategoria/klasa, grupi, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për pozicion. Ndërsa për pozicionin “Inspektor i Policisë Bashkiake”, në pikën 7 të Lidhjes nr. 3, është përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë paga 81.800 lekë.

Referuar dokumentacionit (lista e pagave) të vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë, rezulton se dhe inspektorë të tjerë: E.M, L.T, E.Q, D.M, A.M, etj, kanë të njëjtën pagë me ankuesin. Ky dokumentacion nuk mbështet pretendimin se ankuesi është trajtuar ndryshe nga punonjës të tjerë në të njëjtën kategori pune dhe me të njëjtin nivel arsimor.

Sa i përket pretendimit për shtesën e vjetërsisë, nga VKB nr. 133, datë 22.12.2023, rezulton se shtesa e vjetërsisë është e lidhur me kategoritë dhe grupimet e përcaktuara në Lidhjen nr. 3. Referuar këtij vendimi rezulton se për kategorinë Inspektor i Policisë Bashkiake nuk është parashikuar shtesë e veçantë për vjetërsi në të njëjtën mënyrë si për kategoritë e tjera të tabelës. Për sa kohë ky rregull është zbatuar njësoj për punonjësit e së njëjtës kategori, nuk rezulton që ankuesi të jetë trajtuar në mënyrë të pabarabartë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se llogaritja e pagës së ankuesit në masën 81.800 lekë, si dhe mosllogaritja e shtesave të pretenduara prej tij, nuk provojnë trajtim të padrejtë, të pafavorshëm apo të pabarabartë, për sa kohë rezulton se e njëjta mënyrë llogaritjeje është zbatuar edhe për punonjës të tjerë të së njëjtës kategori.

Në përfundim të analizës së akteve dhe provave të administruara, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankuesit lidhur me transferimet, procedurën disiplinore, masën disiplinore, llogaritjen e pagës dhe vjetërsisë në punë nuk provojnë se ai është vendosur në një pozitë të padrejtë, të pafavorshme apo të pabarabartë në raport me punonjës të tjerë të Policisë Bashkiake në situatë të njëjtë ose të ngjashme.

Për këto arsye, Komisioneri çmon se nuk provohet që ankuesi, z. E.Z, të jetë vendosur në pozita të padrejta, të pafavorshme dhe të pabarabarta në kuptim të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Në nenin 12/1/c) të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohe diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara nuk rezultoi se ankuesi është vendosur në pozita të pafavorshme nga ana e Bashkisë Tiranë, sa i përket marrëdhënieve të punësimit.

Në mungesë të trajtimit të pafavorshëm të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pafavorshëm të tij, të lidhur domosdoshmërisht me *“shkaqet”* e pretenduara.

Komisioneri, vlerëson se nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, nga ana e Bashkisë Tiranë (Policia Bashkiake), lidhur me trajtimin e ankuesit, gjatë marrëdhënieve të punësimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të ankuesit Z. E.Z, në të drejtën për punësim, nga ana e Bashkisë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)